

ANKETA ME NDËRMARRJE

Gjinia e Pronarëve të Ndërmarrjeve

1



Ndërmarrjet e **burrave: 80%**
Ndërmarrjet e **grave: 18%**
Ndërmarrjet me **disa partnerë: 2%**

Funksionimi i Ndërmarrjeve

2



13% e ndërmarrjeve kishin **ndërprerë aktivitetin e tyre plotësisht** deri në mars 2021 (njëjtë si në nëntor 2020), në krahasim me 56% në maj 2020.




Më pak raportuan **ndërprerje të pjesshme** të aktivitetit (**23%**), kur krahasohet me situatën gjatë nëntorit 2020 (40%), (31% në maj 2020)



Vetëm **20%** e ndërmarrjeve të cilat kishin pezulluar plotësisht ose pjesërisht aktivitetin e tyre **paguanin rroga të plota** për të gjithë punonjësit e tyre gjatë periudhës tetor 2020 deri në shkurt 2021.

Tri arsyet kryesore për mbylljen e aktiviteteve të biznesit



Mbështetja Ndaj Masave Kufizuese

3

Raundi **1** **60%** mbështesin masat kufizuese deri diku, **22%** kundërshtojnë deri diku

Raundi **2** **27%** mbështesin masat kufizuese deri diku, **58%** kundërshtojnë deri diku

Raundi **3** **29%** mbështesin masat kufizuese deri diku, **61%** kundërshtojnë deri diku

Ndikimi Financiar

4



Në mars 2021, 41% deklaruan që **ndikimi i pandemisë** kishte qenë shumë negativ, kjo tregon një përmirësim krahasuar me nëntorin 2020 (55%).



Si në nëntor 2020, 88% e ndërmarrjeve raportuan **rënie në shitjet** e produkteve ose shërbimeve, ndërsa 82% e tyre raportuan rënie **në të ardhura**.



Shpenzimet dhe kostot e punës në anën tjetër janë rritur për ndërmarrjet në mars 2021 për 38% dhe 35% respektivisht (në nëntor 2020, për 44% dhe 19%, respektivisht).

Pritjet për të Ardhmen

5

Vetëm 4% besuan se mund të përballen me këtë situatë për më pak se një muaj (8% në nëntor 2020, 11% në maj 2020) dhe 12% besuan se ndërmarrja e tyre mund të përballonte situatën për një deri në dy muaj më tepër (25% në nëntor 2020 dhe 35% në maj 2020).

Ndihma financiare dhe zbatimi i masave të rimëkëmbjes ekonomike shihen si përparësi nga **institucionet e Kosovës**.

Të dhëna krahasuese në mes të tri rraundeve të vlerësimit tregojnë që ndërmarrjet në Kosovë duket të jenë **më të sigurt në aftësitë e tyre për të përballuar** situatën aktuale në mars 2021.

27% parashikuan që ndërmarrjet e tyre do të jenë në gjendje të përballonin situatën aktuale për **më shumë se gjashtë muaj** (19% në nëntor 2020 dhe 10% në maj 2020).

Një numër konsiderueshëm më i vogël i ndërmarrjeve të grave deklaruan se ndërmarrjet e tyre mund të përballojnë **situatën aktuale të pandemisë** për më shumë se gjashtë muaj (21%), krahasuar me ndërmarrjet e burrave (32%).